



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2023 – Numri: 100

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 6 korrik 2023

PËRMBAJTJA

Faqe

Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 30.6.2023	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e komandimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror.....	10767
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 432, datë 30.6.2023	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror.....	10768
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 433, datë 30.6.2023	Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove.....	10776
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 434, datë 30.6.2023	Për përcaktimin e rregullave më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar për përmbaruesin gjyqësor shtetëror.....	10781
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 375, datë 20.6.2023	Për importimin dhe tregtimin e produkteve alergjike.....	10782
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 6.6.2023	Mbi miratimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022.....	10783
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 24, datë 23.6.2023	Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a.....	10785

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 27, datë 23.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave”	10786
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 28, datë 23.6.2023	Për shtyrje afati të aplikimit nga shoqëritë ujësjellës-kanalizime për tarifa të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura për vitin 2023.....	10787



UDHËZIM

Nr. 6, datë 30.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN
E KOMANDIMIT TË PËRMBARUESIT
GJYQËSOR SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 43, pika 6, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

UDHËZOJ :

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të komandohet si inspektor në strukturën përgjegjëse për inspektimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit.

2. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të komandohet vetëm me pëlqimin e tij, për një periudhë jo më shumë se 1 (një) vit, me të drejtë rikomandimi.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror nuk lejohet të komandohet, kur:

- a) është në periudhë prove;
- b) është kryetar i zyrës përmbarimore;
- c) është i transferuar përkohësisht;

ç) nuk garantohet përmbushja e funksionit me eficiencë dhe në kohë i zyrës përmbarimore ku ka emërimin;

d) ka masë disiplinore në fuqi;

dh) ka më pak se 2 (dy) vjet punë si përmbarues gjyqësor shtetëror.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, në bazë të vlerësimit të nevojave të punës, publikon në faqen zyrtare të saj kërkesën për kandidaturë për plotësimin e pozicionit të inspektorit përmes procedurës së komandimit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit pranon kandidaturat e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë që përmbushin kriteret specifike të pozicionit të inspektorit në strukturën përgjegjëse të saj për inspektimin.

6. Kërkesa qëndron e shpallur për një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga publikimi dhe

përmban informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë të inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin, si dhe përcakton:

a) afatin e kandidimit, i cili është 2 (dy) javë nga data e shpalljes së kërkesës;

b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;

c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

7. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim në pozicionin e inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;

b) jetëshkrim, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit;

c) aktin e emërimit si përmbarues gjyqësor shtetëror, të nxjerrë nga ministri i Drejtësisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;

ç) rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;

d) çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit si inspektor.

8. Struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit mund të kërkojë informacion dhe të dhëna për kandidatët nga zyrat përmbarimore përkatëse ku kanë emërimin, lidhur me aftësitë e tyre profesionale, organizative dhe etike të shfaqura gjatë ushtrimit të funksionit.

9. Struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, brenda 2 (dy) javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një relacion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të zyrës përmbarimore vendore ku përmbaruesi gjyqësor shtetëror ushtron funksionin.

10. Struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit i paraqet drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit për shqyrtim emrin/at e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit të inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin dhe propozimin për kandidatin fitues, si dhe emrin/at e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret, së bashku me relacionet përkatëse për secilin kandidat.



11. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të zyrës përbarimore vendore ku ushtron funksionin e tij, përjashtohet nga komandimi.

12. Drejtori i përgjithshëm i Përbarimit, pas kryerjes së verifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 9, 10 dhe 11 të këtij udhëzimi, brenda 5 (pesë) ditëve nxjerr urdhrin për komandimin e përbaruesit gjyqësor shtetëror të përzgjedhur, si inspektor në strukturën përgjegjëse për inspektimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit.

13. Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet dhe/ose kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet për nevoja të punës komandimi, Drejtorja e Përgjithshme e Përbarimit, mund të rishallë kërkesën për kandidatura nga radhët e përbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

14. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Përbarimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 432, datë 30.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN,
ZHVILLIMIN, PËRMBAJTJEN E
PROVIMIT TË PRANIMIT, SI DHE
PROCEDURËN E VLERËSIMIT DHE
SHPLLJES SË REZULTATEVE PËR
PËRMBARUESIN GJYQËSOR
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, pika 5, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky urdhër ka për objekt përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit për përbarues gjyqësor shtetëror, si dhe procedurën e vlerësimit dhe të shpalljes së rezultateve.

Neni 2

Pranimi në Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Shtetëror bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, i cili organizohet nga Këshilli i Përbarimit.

KREU II
**ORGANIZIMI, ZHVILLIMI DHE
PËRMBAJTJA E PROVIMIT TË PRANIMIT**

Neni 3
Organizimi i provimit të pranimit

1. Provimi i pranimit për përbarues gjyqësor shtetëror bazohet në procedura transparente, metoda vlerësimi të drejta dhe të besueshme dhe në një nivel të lartë të njohurive profesionale të pjesëmarrësve.

2. Provimi organizohet për të gjithë individët që përmbushin kushtet e parashikuara në shkronjat “a”–“ë”, të nenit 16, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

3. Provimi i pranimit planifikohet për zhvillim bazuar mbi kërkesat dhe nevojat publike për numrin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 11, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

4. Ministri i Drejtësisë, pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Përbarimit, përcakton me urdhër numrin e vendeve vakante të përbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

5. Këshilli i Përbarimit përcakton me vendim datën, orën dhe vendin e provimit të pranimit. Vendimi i Këshillit të Përbarimit publikohet në



faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Thirrja për shprehjen e interesit për hyrjen në provimin e pranimit publikohet në Buletin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit organizon punën për regjistrimin e kërkesave të paraqitura për shprehje interesi, verifikimin e dokumentacionit shoqërues, si dhe kur kërkohet, informon personat e interesuar lidhur me kushtet ligjore që duhen plotësuar, dokumentacionin që duhet dorëzuar, si dhe afatet përkatëse.

Neni 4

Paraqitja e kërkesës për shprehje interesi dhe dokumentacionit shoqërues

1. Kandidati për përmbarrues gjyqësor shtetëror paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit kërkesën për shprehje interesi dhe dokumentacionin shoqërues brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të thirrjes për paraqitjen e kërkesave për shprehje interesi.

2. Kërkesa për shprehje interesi përmban këto të dhëna:

- a) emrin, mbiemrin, atësinë, amësinë, datëlindjen, vendlindjen, numrin personal të identifikimit, gjininë dhe shtetësinë e kandidatit;
- b) adresën e vendbanimit, numrin telefonik të kontaktit dhe adresën elektronike të kandidatit;
- c) shkaqet e motivimit për të qenë pjesë e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror.

3. Kandidati për përmbarrues gjyqësor shtetëror paraqet edhe dokumentacionin shoqërues si vijon:

- a) kopje të mjetit të identifikimit;
- b) jetëshkrimin;
- c) kopje të njësuar me origjinalin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës ose diplomën e të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) vërtetim, nga punëdhënësi i fundit dhe/ose organet disiplinore, që nuk është larguar nga detyra

ose i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, si dhe vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) kopje të njësuar me origjinalin të librezës së punës që të vërtetojë periudhën e vjetërsisë në punë;

dh) vërtetim i gjendjes gjyqësore;

e) raportin mjeko-ligjor për aftësimin e tij të përgjithshëm në kuadër të kryerjes së detyrës si përmbarrues gjyqësor shtetëror;

ë) dëshmi, vërtetime dhe rekomandime nga persona dhe institucione ku kanë punuar në vitet e fundit;

f) deklaratë që vërteton se nuk është anëtar i partive politike;

g) çdo dokument tjetër që çmohet i nevojshëm për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve ligjore për përmbarrues gjyqësor shtetëror.

Neni 5

Verifikimi i përmbushjes së kriterëve

1. Këshilli i Përmbarrimit organizon menjëherë punën për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve të interesuar, duke marrë në shqyrtim dokumentacionin e depozituar prej tyre me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore për përmbarrues gjyqësor shtetëror.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit për depozitimin e kërkesave për shprehje interesi dhe dokumentacionit shoqërues, Këshilli i Përmbarrimit kryen verifikimin paraprak nëse dosja e kandidatit për përmbarrues gjyqësor shtetëror përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij urdhri.

3. Në rast se Këshilli konstaton se dosja e kandidatit për përmbarrues gjyqësor shtetëror nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij urdhri, njofton kandidatin për plotësimin e të metave brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit. Në këtë rast struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit ndihmon në mënyrë aktive kandidatin për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procedurës së verifikimit paraprak ose përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, Këshilli i



Përmbartimit vlerëson nëse kandidatët plotësojnë kushtet ligjore për përmbartues gjyqësor shtetëror, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligj dhe në këtë urdhër.

Neni 6 Publikimi i listës

1. Lista kualifikuese për të marrë pjesë në provim, si dhe lista e të skualifikuarve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para ditës së organizimit të provimit.

2. Personat që janë renditur në listën skualifikuese, kanë të drejtë t'i drejtohen me ankesë Këshillit të Përmbartimit, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e publikimit të listave, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Pas shqyrtimit të ankesave dhe njoftimit mbi vendimmarrjen, të personave që i kanë paraqitur ato, Këshilli i Përmbartimit publikon në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit listën përfundimtare të të kualifikuarve për provim jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para ditës së organizimit të provimit.

Neni 7 Vlerësimi me pikë i provimit të pranimit

Provimi vlerësohet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë, nga të cilat provimi me shkrim përbën 75 (shtatëdhjetë e pesë) pikë të numrit total të pikëve dhe pjesa e provimit me gojë përbën 25 (njëzet e pesë) pikë.

Seksioni I Provimi me shkrim

Neni 8 Pyetjet e provimit me shkrim

Provimi me shkrim organizohet në formën e pyetjeve me alternativa dhe me zhvillim, të cilat kanë si qëllim të identifikojnë dhe të vlerësojnë aftësitë e kandidatit për ushtrimin e funksionit të përmbartuesit gjyqësor.

Neni 9 Përmbajtja e provimit të pranimit

Provimi i pranimit përmban pyetje së paku nga temat që lidhen me kuadrin ligjor të mëposhtëm:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) legjislacioni që rregullon veprimtarinë e ekzekutimit dhe atë të veprimtarive dytësore, si Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, Kodi i Etikës së përmbartuesit gjyqësor shtetëror, si dhe aktet nënligjore në fuqi;
- c) Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- ç) Kodi i Familjes;
- d) ligji nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar;
- dh) ligji nr. 9699, datë 18.12.2006 “Për masa mbrojtëse ndaj ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- e) Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- ë) ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
- f) ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- g) ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- gj) ligji nr. 110/2016, “Për falimentimin”;
- h) Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- i) ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafiqeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- j) ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- k) Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- l) Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- m) ligji nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.



Neni 10

Përgatitja e pyetjeve të provimit me shkrim dhe zgjedhja e tezës

1. Provimi i pranimit përgatitet nga Këshilli i Përmbartimit jo më herët se 1 (një) ditë para datës së zhvillimit dhe nuk duhet t'u bëhet e ditur personave të tjerë.

2. Pyetjet e provimit hartohen në disa teza të ndryshme, të cilat futen në zarfe të ndryshme, prej të cilave njëri prej tyre do të zgjidhet për t'u përdorur në testin me shkrim në provim.

3. Të gjitha zarfet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Përmbartimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për zarfet në të cilat ndodhen përgjigjet e tezave përkatëse.

Neni 11

Përgjedhja e tezës së provimit të pranimit

1. Zgjedhja e zarfit do të bëhet me short ditën që do të organizohet provimi me shkrim dhe në prani të kandidatëve.

2. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar, në të kundërtën, teza në të është e pavlefshme dhe zëvendësohet me një zarf tjetër të mbyllur.

3. Pas përzgjedhjes, zarfi hapet nga Këshilli i Përmbartimit dhe teza e përzgjedhur u bëhet e ditur publikisht kandidatëve nga kryetari i Këshillit të Përmbartimit.

Neni 12

Paraqitja dhe identifikimi i kandidatëve

1. Hyrja për në ambientet e brendshme për zhvillimin e provimit të pranimit bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për provimin në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Të interesuarit e kualifikuar për të marrë pjesë në provim paraqiten ditën e provimit në ambientet e zhvillimit të provimit me mjet identifikimi personal të vlefshëm, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë.

3. Kandidatët që nuk kanë mjete identifikimi të vlefshme, sipas pikës 2 të këtij neni, përjashtohen nga e drejta për të marrë pjesë në provim.

Neni 13

Deklarimi dhe dorëzimi i sendeve personale

Pas identifikimit, kandidatët udhëzohen të deklarojnë dhe të dorëzojnë për ruajtje, pranë personave të caktuar për këtë qëllim, të gjitha sendet personale ose pajisjet, duke përfshirë: çantë, dosje, laps ose stilolaps, mjete elektronike ose mjete të tjera komunikimi, të cilat nuk lejohen në sallën e provimit.

Neni 14

Procedura përpara zhvillimit të provimit me shkrim

1. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore të caktuar nga administratorët e provimit dhe për asnjë arsye nuk mund të ndryshojnë vendin e caktuar ose të dalin jashtë.

2. Asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në sallën e provimit, përfshirë këtu edhe kandidatët që janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

3. Kandidatëve u shpërndahet baza materiale e nevojshme për kryerjen e testit dhe kopje të parapërgatitura të testit së provimit, të cilat kanë në çdo fletë nënshkrimin e kryetarit të Këshillit të Përmbartimit, si dhe kodin e provimit. Kodi i provimit do të jetë një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të testit dhe për çdo kandidat, i cili do të përdoret gjatë gjithë procesit të zhvillimit të provimit.

4. Pas shpërndarjes së provimit, kandidatëve u kalohet një listë me emrat e tyre dhe secili shënon kodin përbri emrit të vet. Pas përfundimit të shënimit të kodeve nga të gjithë kandidatët, lista mbyllet në një zarf të veçantë.

Neni 15

Mbikëqyrja e procesit të zhvillimit të provimit

1. Procesi i zhvillimit të provimit me shkrim mbikëqyret nga administratorët e provimit, që përzgjidhen nga radhët e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, si dhe të paktën dy përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

2. Administratorët e provimit garantojnë mbarëvajtjen e procesit të mbikëqyrjes së provimit,



duke ndjekur udhëzimet e anëtarëve të Këshillit të Përmbartimit.

3. Administratorët e provimit, përpara zhvillimit të provimit me shkrim, nënshkruajnë deklaratë personale se nuk kanë lidhje dhe se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me kandidatët që marrin pjesë në provim.

Neni 16

Rregullat e sjelljes gjatë zhvillimit të provimit me shkrim

1. Përpara fillimit të provimit me shkrim, kandidatët udhëzohen që:

a) të respektojnë kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve, e cila gjendet e përcaktuar në provim;

b) të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë mjedisit ku zhvillohet testimi;

c) të mos shënojnë ose të mos lënë emrin, të mos bëjnë shenja sado të vogla, shprehje apo citime në tezë apo në fletët e përgjigjeve, të cilat mund ta bëjnë kandidatin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara dhe të mos përdorin baza të tjera materiale, veç atyre të vëna në dispozicion Këshilli;

dh) të komunikojnë me anëtarët e Këshillit, në rast nevojë, e cila duhet të jetë me zë të ulët dhe duke e thirrur në vendin e zhvillimit të testimit;

e) të njihen me përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) të ndjekin udhëzime e sqarime të tjera të rastit, e të vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

2. Pas njoftimit si më sipër, mbi rregullat e provimit, çdo kandidat ftohet të plotësojë një deklaratë me shkrim sipas modelit në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij, se u njoh me rregullat dhe i pranon ato, si dhe se është i ndërgjegjshëm se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi.

3. Refuzimi për nënshkrimin e deklaratimit apo kundërshtimi i përmbajtjes së tij sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.

Neni 17

Skualifikimi për mosrespektim të udhëzimeve

1. Kandidati që gjatë testimit me shkrim nuk respekton udhëzimet e dhëna, njoftohet pa paralajmërim të ndërprerë testimin dhe të lërë menjëherë sallën, duke iu komunikuar edhe skualifikimi nga procedura e provimit.

2. Kandidati i skualifikuar, sipas pikës 1, barazohet me kandidatët që nuk e kanë marrë minimumin e nevojshëm të pikëve për t'u kualifikuar. Në këtë rast, përkrah emrit të personit bëhet shënimi "Skualifikohet", vihet në dijeni kryetari i Këshillit të Përmbartimit dhe bëhet pasqyrimi në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës së kandidatit të skualifikuar, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit.

3. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Përmbartimit dhe bëhet pjesë e dosjes mbi procedurat e zhvilluara duke i bashkëlidhur edhe testet dhe përgjigjet e kandidatëve të skualifikuar.

Neni 18

Procedura pas përfundimit të provimit me shkrim

1. Pas përfundimit të kohës së caktuar për testimin, bëhet mbledhja e përgjigjeve të testit të kandidatëve, si dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura në testim dhe nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse, sipas parashikimeve të mësipërme.

2. Të gjitha fletët e përgjigjeve të testit me shkrim vulosen në pjesën e pasme me vulën e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

3. Pasi të gjithë kandidatët dorëzojnë përgjigjet e testit për vlerësim, hapet zarfi ku ndodhen dy kopje me përgjigjet e tezës.

4. Këshilli i Përmbartimit administron njërin nga kopjet e përgjigjeve, ndërsa kopja tjetër publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe Ministrisë së Drejtësisë.



Seksioni II

Vlerësimi i provimit me shkrim dhe shpallja e rezultateve

Neni 19

Vlerësimi i provimit me shkrim dhe vlerësimi me pikë

1. Këshilli i Përmbarrimit përfundon procesin e vlerësimit të provimeve me shkrim jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e përfundimit të provimit.

2. Secili prej anëtarëve të Këshillit kryen vlerësimin e pavarur të çdo provimi, dhe në fund, përlogariten pikët mesatare të të gjithë anëtarëve për çdo pyetje. Në fund të korrigjimit, Këshilli i Përmbarrimit përlogarit shumën totale të pikëve të fituara nga çdo kandidat gjatë kontrollit të njohurive me shkrim.

3. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi dokumentohet me procesverbal nga një prej anëtarëve të Këshillit të Përmbarrimit, që zgjidhet nga kryetari.

4. Anëtarët e Këshillit të Përmbarrimit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve në mbledhje.

5. Vlerësimi i testeve dhe përgjigjet e pyetjeve me shkrim nënshkruhen në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Përmbarrimit.

6. Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Përmbarrimit.

7. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për të gjitha testet e korrigjuara, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidat shënohen pikët e fituara.

Neni 20

Publikimi i rezultateve të provimit me shkrim

1. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Përmbarrimit. Një kopje e saj, e cila përmban vetëm kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët, publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Për efekt ankimi, publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

Neni 21

Ankimi ndaj rezultateve të provimit me shkrim

1. Kandidatë që kanë vërejtje për vlerësimin e provimit me shkrim, kanë të drejtë të ankohen brenda 3 (tri) ditëve nga dita e afishimit të listës pranë Këshillit të Përmbarrimit.

2. Këshilli i Përmbarrimit shqyrton ankimet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas kalimit të këtij afati dhe vë në dijeni ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit.

Neni 22

Kufiri i pikëve për kalimin në provimin me gojë

Kandidati që vlerësohet me të paktën 60 pikë në pjesën e kontrollit të njohurive me shkrim, kalon në testin e kontrollit të njohurive me gojë.

Seksioni III

Provimi me gojë

Neni 23

Zhvillimi i provimit me gojë

1. Provimi me gojë zhvillohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankimeve, sipas nenit 21 të këtij urdhri.

2. Rregullat për paraqitjen dhe identifikimin e kandidatëve gjatë zhvillimit të provimit me shkrim zbatohen edhe gjatë zhvillimit të provimit me gojë.

3. Provimi me gojë regjistrohet nëpërmjet mjeteve audio ose audiovizive.

Neni 24

Pyetjet e provimit me gojë

1. Provimi me gojë përmban pyetje për të testuar njohuritë profesionale, teorike dhe aftësitë praktike të kandidatit në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm përmbarrimor, si dhe në fusha të tjera që lidhen me veprimtarinë dytësore të përmbarruesit gjyqësor.

2. Për përgatitjen e pyetjeve të provimit me gojë zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara për provimin me shkrim.



Neni 25

Procedura përpara zhvillimit të provimit me gojë

1. Të gjithë kandidatët ftohen të hyjnë dhe zënë vend në ambientin e pritjes për t'u futur në sallën ku do të zhvillohet provimi dhe ndodhet Këshilli i Përmbarrimit.

2. Asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në ambientin e pritjes apo sallën e testimit, përfshirë këtu edhe kandidatët të cilët janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

3. Pasi zënë vend, kandidatët udhëzohen që:

a) të respektojnë kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve;

b) të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë ambientit të pritjes ku zhvillohet provimi;

c) të mos bëjnë shenja, shprehje apo citime përpara ose gjatë zhvillimit të testimit, të cilat mund ta bëjnë kandidatin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara;

dh) të komunikojnë me anëtarin e Këshillit vetëm përpara hyrjes në sallën e provimit dhe në rast nevojë, si dhe me zë të ulët;

e) të njihen me përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) të largohen nga salla e testimit dhe ambientet e pritjes menjëherë pas përfundimit të testit;

f) të ndjekin udhëzime e sqarime të tjera të rastit e të vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

4. Për nënshkrimin e deklaratës me shkrim dhe skualifikimin për mosrespektim të udhëzimeve zbatohen të njëjtat rregullat të përcaktuara për provimin me shkrim.

5. Njëri nga anëtarët e Këshillit fton në sallën e testimit me radhë kandidatët bazuar në kodet përkatëse të provimit, të renditur në rend rritës, si dhe e shoqëron atë në dalje nga ambientet ku zhvillohet testimi.

Seksioni IV

Vlerësimi i provimit me gojë dhe shpallja e rezultateve

Neni 26

Vlerësimi i njohurive me gojë

1. Menjëherë pas përfundimit të provimit me gojë, anëtarët e Këshillit të Përmbarrimit japin vlerësimin e tyre në lidhje me rezultatet e secilit kandidat në mbledhje me dyer të mbyllura.

2. Anëtarët e Këshillit votojnë për vlerësimin me pikë dhe janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe të votimit në mbledhje.

3. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Këshilli.

Neni 27

Llogaritja e pikëve

1. Pas vlerësimit me pikë për provimin me gojë, Këshilli i Përmbarrimit përlogarit shumën totale të pikëve të fituara nga kontrolli i njohurive me shkrim dhe me gojë dhe i shënon ato në listën përkatëse.

2. Për marrjen e vendimit për përlogaritjen e pikëve të përgjithshme për çdo kandidat, mbahet procesverbal nga një prej anëtarëve të Këshillit, që zgjidhet nga kryetari dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, përfshirë edhe ata që nuk pajtohen me vendimin.

3. Anëtari, që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, e nënshkruan procesverbalin me shënimin: “*Nuk pajtohem me vendimin. Bashkëlidhur paraqes mendimin tim*”. Anëtari në pakicë paraqet veçmas, me shkrim, mendimin e tij dhe pasi nënshkruhet nga hartuesi, i bashkëlidhet procesverbalit.

4. Në rast se anëtari i Këshillit të Përmbarrimit, i cili ka mendim të kundërt me shumicën, nuk përçatit mendimin e tij me shkrim si më lart, kundërshtimi i tij konsiderohet i paqenë.



Neni 28
Shpallja e fituesve

1. Kandidati që ka kaluar provimin me shkrim dhe që në provimin me gojë vlerësohet me jo më pak se 20 pikë, konsiderohet fitues.

2. Kandidatët që kalojnë me sukses provimin e pranimit renditen në përputhje me rezultatet e arritura deri në plotësimin e vendeve vakante sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë. Në rast se për vendin e fundit kanë fituar të njëjtin numër pikësh më shumë se një kandidat, kandidati fitues përcaktohet me anë të shortit, i cili realizohet në prani të kandidatëve me të njëjtin numër pikësh.

3. Lista me kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 29
Ankimi ndaj vlerësimit të rezultateve të provimit me gojë

1. Kandidatët që kanë vërejtje për vlerësimin, kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tri) ditëve nga marrja dijeni për rezultatet e provimit. Ankimi shqyrtohet nga Këshilli i Përmbarrimit brenda 5 (pesë) ditëve.

2. Pas shqyrtimit të ankimeve dhe njoftimit të kandidatëve që kanë paraqitur ankimet, Këshilli i Përmbarrimit përgatit listën me emrat, kodet dhe pikët e fituara për secilin kandidat, e cila nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.

3. Lista i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Këshilli i Përmbarrimit. Një kopje e listës përfundimtare me kodet dhe me pikët e fituara për secilin kandidat publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 30
Dokumentimi i procesit

Procesverbalet, përgjigjet e testeve të dhëna nga kandidatët, testet e skualifikuara, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër që krijohet dhe i përket procesit të organizimit dhe zhvillimit të provimit, shpalljes së rezultateve dhe të kandidatëve që kalojnë me sukses provimin, ruhen në arkivin e

Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31
Strukturat e ngarkuara për zbatim

1. Ngarkohet Këshilli i Përmbarrimit, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarrimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCA NR. 1
**DEKLARATË PËR NJOHJE ME
RREGULLAT E PROVIMIT TË PRANIMIT**

DEKLARATË

Deklaroj se, pasi u njoha me rregullat e provimit të pranimit dhe i pranoj ato, jam i ndërgjegjshëm se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi.

(emër, atësi, mbiemër) nënshkrim

Refuzimi për nënshkrimin e deklarimit apo kundërshtimi i përmbajtjes së tij, sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.

**URDHËR**

Nr. 433, datë 30.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR ORGANIZIMIN DHE
PËRMBAJTJEN E PROGRAMIT TË
TRAJNIMIT, PJESËMARRJEN NË
TRAJNIME, SI DHE TESTIMIN E
NJOHURIVE TË PËRFITUARA PËR
PËRMBARUESIT GJYQËSORË
SHTETËRORË NË PERIUDHË PROVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19, pika 4, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit dhe institucionet trajnuese për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

RREGULLORE**PËR ORGANIZIMIN DHE PËRMBAJTJEN
E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR
PËRMBARUESIT GJYQËSORË
SHTETËRORË NË PERIUDHË PROVE,
PJESËMARRJEN NË TRAJNIME, SI DHE
TESTIMIN E NJOHURIVE TË
PËRFITUARA****KREU I
DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të detyrueshëm të trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, për pjesëmarrjen në trajnime, si dhe për testimin e njohurive të përfituara në përfundim të trajnimit.

**Neni 2
Përkufizime**

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Program i detyrueshëm i trajnimit” përfshin një tërësi veprimtarish akademike dhe kërkimore shkencore me ngarkesë akademike normale prej jo më pak se 200 orësh në një periudhë 6-mujore, e cila ka si qëllim aftësimin e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë me njohuritë e duhura profesionale për ushtrimin e veprimtarisë përbarimore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën përmbaruesit gjyqësor shtetëror të pajiset me certifikatën përkatëse.

b) “Certifikatë” është dëshmia që lëshohet nga institucioni që zhvillon trajnimin për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove.

**Neni 3
Objektivat e programit të detyrueshëm të
trajnimit**

Programi i detyrueshëm i trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë



prove synon përmbushjen e objektivave të mëposhtëm:

a) ofrimin e një programi trajnimi të përshtatshëm, që reflekton kompetencat dhe detyrat në ushtrimin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror gjatë periudhës së provës;

b) aftësimin e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove me njohuritë e duhura profesionale për ushtrimin e veprimtarisë përmbarimore;

c) formimin profesional të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove në përmbushjen e veprimtarisë përmbarimore, sipas legjislacionit në fuqi dhe krijimin e praktikave të unifikuara përmbarimore;

ç) ofrimin e mundësisë së angazhimit në punë në ekip, me qëllim që të rrisin zhvillimin e tyre profesional në kontribut të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit përmbarimor gjyqësor;

d) nxitjen e frymës së bashkëpunimit profesional ndërmjet përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, përmes aktiviteteve akademike përkatëse.

Neni 4

Synimi për kualifikim

Aftësimi profesional i përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, përmes trajnimeve, arrihet, duke përvetësuar kompetencat, si më poshtë:

a) përmbushjen e kërkesave të përgjithshme për profesionin e përmbaruesit gjyqësor në Shqipëri;

b) njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si përmbarues gjyqësor;

c) aftësinë për t'u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme;

ç) aftësinë për të përdorur dhe për të zbatuar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë (profesionale, metodike, sociale dhe personale);

d) zhvillimin e aftësive praktike dhe forcimi i ndërgjegjësimit mbi ndërlidhjen e dimensioneve juridike, sociale dhe ekonomike;

dh) aftësinë për kërkime të pavarura në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional;

e) kërkesat për menaxhimin dhe përmbushjen me sukses të procesit të punës, të tilla si vetorganizimi dhe disiplina, aftësia për t'u përballur me ngarkesë të lartë pune etj.

KREU II

ORGANIZIMI DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË DETYRUESHËM TË TRAJNIMIT

Neni 5

Programi i detyrueshëm i trajnimit

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit fokusohet në aftësimin profesional teorik dhe praktik të përmbaruesve gjyqësorë në periudhë prove, në zhvillimin e kompetencave profesionale të përmbaruesve, si dhe vlerat etike të tyre, si më poshtë:

a) ngritja dhe forcimi i kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar;

b) hartimi i akteve dhe kryerja e veprimeve procedurale në funksion të ushtrimit të detyrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) zbatimi i rregullave etike;

ç) përshtatja me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të kompetencave;

d) zhvillimi i aftësive në fushën e përmbarimit;

dh) zhvillimi i aftësive sociale;

e) zhvillimin e praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e përmbaruesve;

ë) zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese.

2. Kompetencat e mësipërme do të zhvillohen nëpërmjet moduleve të trajnimit, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij dokumenti, trajnimit praktik, si dhe punës praktike që mund t'i caktohet nga stafi trajnues.

3. Programi i detyrueshëm i trajnimit përbëhet së paku nga temat mbi:

a) Kodin Civil;

b) Kodin e Procedurës Civile;

c) të drejtën private në tërësi;

ç) legjislacionin për shërbimin përmbarimor gjyqësor;

d) aspekte të veçanta të së drejtës publike;

dh) etikën profesionale.

4. Nisur nga nevojat e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, ndryshimet e legjislacionit dhe problemet e praktikës, karakteri i programit të detyrueshëm i trajnimit mund të lejojë përfshirjen e tematikave të tjera.



Neni 6

Institucionet trajnuese

1. Institucione trajnuese janë sipas nenit 19, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”.

2. Trajnimet e organizuara nga institucionet trajnuese, publikohen dhe i njoftohen në çdo rast Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit.

3. Për qëllime të veprimtarisë administrative dhe akademike, institucioni trajnues krijon dhe administron regjistrat përkatës, në lidhje me përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove që ndjekin programin e detyrueshëm të trajnimit.

Neni 7

Organizimi i programit të detyrueshëm i trajnimit

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit është një program që zhvillohet për një kohëzgjatje prej jo më pak se 200 orësh në 6 muaj dhe u ofrohet përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”, kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera në fuqi.

2. Për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit, institucioni trajnues harton dhe miraton kalendarin e aktiviteteve trajnuese, numrin e sesioneve trajnuese dhe kohëzgjatjen.

3. Në rastet kur programi i detyrueshëm i trajnimit nuk realizohet nga Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarrimit, në çdo rast, çështjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktohen në bashkëpunim me drejtorinë e përgjithshme të Përmbarrimit.

4. Institucioni trajnues merr masat e nevojshme administrative dhe akademike dhe kujdeset në mënyrë të posaçme për trajnimin e detyrueshëm të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove.

5. Programi tematik publikohet elektronikisht në faqen zyrtare të institucionit trajnues, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, në rastin kur programi i detyrueshëm i trajnimit realizohet nga një institucion tjetër trajnues.

Neni 8

Metodologjia e trajnimit

1. Staf i trajnues i përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove duhet të:

a) zhvillojë një metodë interaktive mësimdhënie;

b) bëjë përpjekje për të ruajtur një ekuilibër mes trajnimit teorik dhe praktik të çështjeve që janë objekt diskutimi, ku prioritet të kenë aspektet praktike;

c) kujdeset për ndërhyrje konstruktive, të shpërndara dhe jodominuese, duke i lënë hapësirë të bollshme diskutimeve nga përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë;

ç) ketë aftësinë për të kombinuar disa metoda të mësimdhënies (prezantimi verbal, prezantim me shkrim, puna në grup, pyetjet, përdorimin e mjeteve audiovizive etj.);

d) ketë aftësi për të prezantuar materialin pa ndonjë mbështetje dokumentare dhe për të përgatitur materialet burimore të nevojshme, mbështetjen e aspekteve teorike dhe praktike, për të vëzhguar nivelin e duhur të ndërveprimit dhe mbështetjen e metodave të trajnimit, qëllimit dhe tematikës së prezantimeve dhe për të qëndruar brenda kohës së përcaktuar për një prezantim;

dh) bashkëpunojë me persona të tjerë që mund të jenë të përfshirë në të njëjtin trajnim apo tematikë.

2. Mësimi organizohet në dy pjesë, pjesa teorike dhe pjesa praktike e së njëjtës lëndë. Kjo ndarje është përcaktuese edhe për metodologjinë e mësimdhënies.

3. Metodologjia përfshin metodën tradicionale të ligjërimit, metodën e simulimit dhe të zgjidhjes së problemeve.

4. Metodologjia e mësimdhënies konsiston në kombinimin e punës teorike me aspektet praktike. Pjesa më e madhe e këtyre seancave praktike kërkojnë që pjesëmarrësit të shkruajnë apo të përgatisin një sasi të konsiderueshme të formave të akteve që lidhen me veprimtarinë përmbarrimore gjyqësore. Pjesa më e madhe e tyre do të jenë të natyrës intensive praktike ndërsa të tjerat do të jenë të organizuara sipas temave përkatëse.



Neni 9

Organizimi i procesit të mësimdhënies

1. Programi i trajnimit për përmbauesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove organizohet i ndarë në grupe. Çdo grup ka një numër të caktuar pjesëmarrësish në raport me numrin e pjesëmarrësve të regjistruar në program.

2. Për çdo grup garantohe zbatimi i njëjtë i programit mësimor.

3. Orari mësimor për çdo grup realizohet në formën e orëve mësimore javore, që hartohen nga institucioni trajnues, mbështetur në planin mësimor. Orari javor bën harmonizimin e elementeve mësimore (leksioneve, debateve profesionale, kërkim i pavarur etj.), duke siguruar shpërndarjen e ngarkesës, si dhe përcakton kohën dhe auditorin e zhvillimit të mësimi.

4. Orari mësimor është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë pjesëmarrësit dhe stafi trajnues. Ai afishohet në vend të dukshëm, në këndin e njoftimeve të institucionit trajnues, si dhe publikohet në faqen zyrtare të tij.

KREU III

**RREGULLAT MBI PJESËMARRJEN
NË TRAJNIME**

Neni 10

Pjesëmarrja në programin e detyrueshëm të trajnimit

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror në periudhë prove, që ka shprehur interesin për ndjekjen e programit të detyrueshëm të trajnimit, njoftohet nga institucioni trajnues në rrugë elektronike lidhur me programin mësimor tematik dhe kalendarin e aktiviteteve mësimore, të cilat do të ndiqen në mënyrë sistematike prej tyre.

2. Në përfundim të çdo teme mësimore të programit të trajnimit, përmbauesve gjyqësorë u përcillet një kopje elektronike e temës respektive dhe një listë sintetike bibliografike, ku stafi trajnues është mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme.

3. Pjesëmarrja e përmbauesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, sipas planifikimit të paracaktuar në përputhje me nenin 9, është e detyrueshme dhe përbën kusht për marrjen e certifikatës së përfundimit të programit.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet kryesore

1. Përmbauesit gjyqësor shtetërorë në periudhë prove kanë të drejtë, të:

a) përdorin infrastrukturën që institucioni trajnues vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga kjo strukturë;

b) shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e stafit trajnues.

2. Përmbauesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove kanë si detyrë të:

a) ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të detyrueshëm të trajnimit;

b) të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga institucioni trajnues dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit;

c) të respektojnë të drejtat e stafit trajnues dhe të përmbauesve të tjerë që ndjekin programin e detyrueshëm të trajnimit.

KREU IV

**TESTIMI I NJOHURIVE TË PËRFITUARA
TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË
SHTETËRORË NË PERIUDHË PROVE**

Neni 12

Rezultatet e pritura në përfundim të programit të detyrueshëm të trajnimit

Pas përfundimit të programit të detyrueshëm të trajnimit, përmbauesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove duhet të jenë në gjendje, ndër të tjera, që:

a) të kenë përvetësuar aspektet e përgjithshme dhe të posaçme të sistemit përmbaimit gjyqësor;

b) të njohin parimet dhe rregullat e ushtrimit të funksionit të përmbauesit gjyqësor, si dhe rregullat e etikës së përmbauesit gjyqësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) të kryejnë veprime procedurale, si dhe të hartojnë akte, të cilat zbatohen në praktikën përmbaimit;

d) të dinë të zbatojnë dispozitat juridike në fushën e përmbaimit gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi;

e) të kuptojnë ndikimin e shprehjeve dhe të terminologjisë juridike të përdorura gjatë hartimit të



akteve shkresore në funksion të ushtrimit të veprimtarisë përbarimore gjyqësore.

Neni 13

Testimi i njohurive

1. Në përfundim të programit të detyrueshëm të trajnimit, përbaruesi i nënshtrohet provimit, që teston të gjitha lëndët dhe temat e zhvilluara.

2. Provimi për kontrollin e njohurive organizohet nga institucioni trajnues, në bazë të moduleve të programit të detyrueshëm të trajnimit.

3. Provimi bazohet në procedura transparente, metoda vlerësimi të drejta dhe të besueshme dhe në një nivel të lartë të njohurive profesionale të përbaruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove që kanë ndjekur programin e detyrueshëm të trajnimit.

4. Provimi vlerësohet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë. Konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin për kontrollin e njohurive, përbaruesi që ka marrë të paktën 80% të pikëve të provimit.

Neni 14

Certifikata

1. Në fund të programit të detyrueshëm të trajnimit, përbaruesit gjyqësorë shtetërorë në

periudhë prove pajisen me certifikatën e përfundimit me sukses të trajnimit, që lëshohet nga institucioni trajnues.

2. Certifikata përmban të paktën këto elemente:

a) emrin;

b) mbiemrin;

c) datat e zhvillimit të programit;

ç) titullin e programit përkatës;

d) nënshkrimin dhe vulën e institucionit përgjegjës për lëshimin e tyre.

3. Në certifikatë, krahas logos së institucionit trajnues, vendoset dhe logoja e Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit, në rastet kur programi i detyrueshëm të trajnimit nuk realizohet nga kjo e fundit.

KREU V

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 15

Efektet financiare

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i programit të detyrueshëm të trajnimit për përbaruesit gjyqësorë shtetërorë përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit.

ANEKSI 1

MODULET E PROGRAMIT TË DETYRUESHËM TË TRAJNIMIT

NR.	EMËRTIMI I MODULIT
1	Sistemi përbarimor në botë dhe në Evropë (praktikat dhe modelet më të mira etj.)
2	Shërbimi përbarimor gjyqësor në Shqipëri (aspektet e përgjithshme, parimet, përbaruesi përballë klientit, raportet kolegjinale të përbaruesit, funksionet dhe të drejtat e detyrat e përbaruesit, përbaruesi në raport me subjektet juridike publike dhe private, aktivitetet jashtë zyrës së përbaruesit, organizimi i përbaruesit etj.)
3	Inspektimi i përbaruesit gjyqësor (mbikëqyrja dhe përgjegjësia disiplinore, hetimi dhe procedimi disiplinor, procedura, shkeljet dhe masat disiplinore, të drejtat dhe detyrimet e subjektit që i nënshtrohet hetimit/procedimit disiplinor etj.)
4	Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit
5	Kuadri ligjor për shërbimin përbarimor dhe veprimtarinë përbarimore
6	Fusha e ekzekutimit vullnetar dhe të detyrueshëm përbarimor, ekzekutimi në fusha të veçanta, pezullimi e pushimi i ekzekutimit etj.
7	Veprimtaria përbarimore (kryerja e veprimeve procedurale, përgatitja e akteve të fushës, elementet përbërëse, ndreqja e gabimeve në to, aksesit në sistemin elektronik; transaksionet financiare, procedurat dhe rregullat e trajtimit të tyre etj.)
8	Veprimtaria dytësore e përbaruesit gjyqësor, rregullat dhe procedurat etj.
9	Bashkëpunimi me institucionet shtetërore për ekzekutimin e detyrueshëm etj.
10	Konflikti i interesit në një procedurë ekzekutive, papajtueshmëritë, praktikat e ndaluara të përbaruesit gjyqësor etj.
11	Menaxhimi i regjistrit dhe i arkivave, shërbimi i dokumentit, evidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe i veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit etj.
12	Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinore (rregullat e komunikimit dhe etika profesionale etj.)
13	Raste të ndryshme nga praktika përbarimore



URDHËR

Nr. 434, datë 30.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
MË TË DETAJUARA PËR KRITERET
DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E
LEJES SË PAPAGUAR PËR
PËRMBARUESIN GJYQËSOR
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”; të ndryshuar dhe të nenit 32, pika 6, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

1. Ky urdhër për qëllim të përcaktojë rregulla më të hollësishme lidhur me:

a) kriteret për dhënie e lejeve të papaguara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë të emëruar përfundimisht;

b) procedurat që ndiqen në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, për dhënie e lejeve të papaguara.

2. Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në paraqitjen e kërkesave për leje dhe zyrat përmbarimore vendore/Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në procedurën e shqyrtimit të tyre, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të mëposhtme:

a) parimi i nxitjes së profesionalizmit dhe zhvillimit të karrierës, sipas të cilit, përmbaruesi gjyqësor shtetëror nxitet t'i japë rëndësi vlerave profesionale, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale;

b) parimi i efikasitetit, sipas të cilit zyrat përmbarimore vendore duhet të jenë funksionale për përmbaruesin në kohë dhe me eficiencë të detyrave të tyre sipas legjislacionit në fuqi;

c) mbrojtja e së drejtës për jetë private dhe familjare, duke ruajtur konfidencialitetin, sipas rastit.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtë që, në raste të veçanta, për nevoja personale ose familjare, të kërkojë leje pa të drejtë page nga kryetari i zyrës përmbarimore, me një kohëzgjatje

maksimale brenda një viti kalendarik jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë.

4. Leja e papaguar sipas pikës 3 të këtij urdhri jepet sipas kriterëve dhe rasteve të përcaktuara në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

5. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 (dy) vjet për arsye shëndetësore, familjare ose për qëllime kualifikimi apo specializimi profesional.

6. Llojet e lejeve të papaguara që u jepen përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë sipas pikës 5 të këtij urdhri, janë:

a) leja për qëllime kualifikimi apo specializimi profesional në përputhje me misionin dhe funksionin e përmbaruesit gjyqësor, jashtë periudhës së formimit vazhdues;

b) leja për arsye familjare ose shëndetësore.

7. Kërkesa për përfitimin e lejes së papaguar, sipas pikës 3, të këtij urdhri, paraqitet te kryetari i zyrës përmbarimore vendore përkatëse. Kërkesa për përfitimin e lejes së papaguar, sipas pikës 5, të këtij urdhri, paraqitet te drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit. Në rastet kur leja e papaguar kërkohet nga kryetari i Zyrës Përmbarimore, kërkesa paraqitet pranë drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit.

8. Kërkesa paraqitet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së parashikuar për fillimin e lejes së papaguar, shoqëruar me dokumentin që provon shkakun ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar lejen e papaguar. Në raste të veçanta, kur leja e papaguar kërkohet për shkaqe që nuk mund të parashikoheshin, përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të kërkojë të fillojë lejen e papaguar jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

9. Kërkesa, në rastet e lejes së papaguar, sipas pikës 5 të këtij urdhri, përmban:

a) përshkrimin e arsyes;

b) afatin e lejes;

c) në rastin e shkronjës “a”, të dhëna për institucionin ky do të kryhet kualifikimi apo specializimi profesional.



10. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues, si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i zyrës përbarimore vendore përkatëse në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të zyrës.

11. Përbaruesi gjyqësor shtetëror mund të përfitojë lejen e papaguar sipas pikës 5 të këtij urdhri, pasi është vlerësuar çdo faktor i rëndësishëm, veçanërisht:

a) shkakut për të cilin kërkohet leja e papaguar;

b) kohëzgjatja e kërkuar;

c) numri i vendeve vakante, si dhe nevoja për të garantuar interesat e funksionit;

ç) përmbushja e funksionit me eficiencë dhe në kohë në zyrën përbarimore vendore përkatëse.

12. Kërkesa për leje të papaguar shqyrtohet jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga data e paraqitjes së saj.

13. Kryetari i zyrës përbarimore vendore përkatëse ose drejtori i përgjithshëm i Përbarimit, sipas rastit, me vendim të arsyetuar, miraton ose refuzon kërkesën për marrjen e lejes së papaguar.

14. Drejtori i përgjithshëm i Përbarimit mund të refuzojë kërkesën për leje sipas shkronjës "a" të pikës 6, nëse kualifikimi profesional ose specializimi bie ndesh me interesat e funksionit dhe vë në rrezik në tërësi përmbushjen e funksionit me eficiencë dhe në kohë në zyrën përbarimore. Drejtori i përgjithshëm i Përbarimit mund të refuzojë kërkesën për leje sipas shkronjës "b" të pikës 6, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me eficiencë dhe në kohë.

15. Në vendimin e arsyetuar për dhënien e lejes së papaguar, drejtori i përgjithshëm i Përbarimit shprehet lidhur me shpërndarjen e dosjeve në ngarkim të përbaruesit gjyqësor shtetëror, subjekt i përfitimit të lejes së papaguar dhe hedhjen në short ose jo të dosjeve përbarimore që përbaruesi gjyqësor shtetëror ka në ekzekutim apo proces.

16. Leja e papaguar dhe kohëzgjatja e saj shënohen në dosjen e personelit të përbaruesit gjyqësor shtetëror.

17. Lejet e papaguara të dhëna përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror", do të vazhdojnë të zbatohen sipas kushteve të vendosura në to.

18. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Përbarimit dhe Zyrat Përbarimore Vendore për zbatimin e këtij urdhri.

19. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja

URDHËR

Nr. 375, datë 20.6.2023

PËR IMPORTIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE ALERGJIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 105, datë 31.7.2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Produktet alergjike janë barna, të cilat duhet të arrijnë një identifikim ose një ndryshim specifik të kërkuar, në lidhje me përgjigjen imunologjike të një agjenti alergjik.

2. Dhënia e autorizimit për tregtim të këtyre produkteve u nënshtrohet dispozitave ligjore të legjislacionit në fuqi për barnat dhe shërbimin farmaceutik.

3. Kërkesa për autorizimin e importit i paraqitet Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nëpërmjet sistemit "e-Albania" nga importuesi i autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit ose prodhuesit e tyre dhe shoqërohet me dokumentacionin që përmban:

a) Certifikatën e analizës;

b) Certifikatën e origjinës;

c) Faturën në të cilën janë shënuar, numri i për gatitjes, emri i produktit alergjik, sasia, numri i serisë, data e skadencës dhe çmimi;

d) *Packing list* në të cilën janë shënuar numri i për gatitjes, emri i produktit alergjik, sasia, numri i serisë dhe data e skadencës.



4. Numri i përgatitjes identifikon emrin e pacientit, i cili ruhet konfidencial dhe është specifik vetëm për një terapi të caktuar.

5. Në paketimin e jashtëm të produktit alergjik gjendet numri i përgatitjes, emri i pacientit, mjeku përshkrues, numri i serisë dhe data e skadencës.

6. Procedurat doganore kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të regjistrojë në një regjistër të veçantë të gjitha të dhënat për produktet alergjike, të cilat do të importohen.

8. Kompania mbajtëse e autorizimit për tregtim ose kompania prodhuese, importuesi i autorizuar dhe farmacitë publike dhe jopublike ruajnë recetat dhe dokumentacionin e nevojshëm, sipas legjislacionit në fuqi dhe i vendosin ato në dispozicion të autoriteteve kompetente.

9. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, kompanitë mbajtëse të autorizimit për tregtim ose kompanitë prodhuese, importuesit e autorizuar dhe farmacitë publike dhe jopublike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 186, datë 6.6.2023

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQATËS SHQIPTARE TË
FURNIZUESVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE (AAES) PËR DISA
NDRYSHIME DHE KUFIZIME NË
ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT
TË ERE-s NR. 23, DATË 14.2.2022**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 105 dhe 144, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e

tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, “Mbi shqyrtimin e kërkesës të AAES-së për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022”,

konstatoi se:

- Ndryshimet dhe kufizimet e propozuara nga Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) të paraqitura me anë të shkresës me nr. 8/1 prot., datë 30.12.2022, protokolluar në ERE me nr. 2150 prot., datë 30.12.2022, u vlerësuan gjatë fillimit të procedurës për shqyrtimin e kërkesës së AAES-së për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 20.2.2023. ERE, pavarësisht kërkesës së AAES-së për aplikimin e përjashtimeve të propozuara vetëm për furnizuesit që furnizojnë konsumatorë të lidhur në tension të mesëm dhe të lartë, vlerësoi që këtë kërkesë ta shtrijë mbi të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitet në tregun e energjisë, në kuadër të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues. ERE, me shkresën me nr. 1009 prot., datë 6.3.2023, iu drejtua palëve të interesit për të shprehur komentet dhe objeksionet nëse do të kishin, lidhur me ndryshimet e publikuara në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, për të cilat filloi procedura.

- Në vijim, vetëm këto palë interesi kanë paraqitur vlerësimet e tyre lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 20.2.2023: shoqëria “EZ-5” sh.p.k., Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK), Autoriteti i Konkurrencës (AK) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

- Meqenëse shumë prej shoqërive nuk iu përgjigjën shkresës së ERE-s, me nr. 1009 prot., datë 6.3.2023, në këto rrethana me qëllim diskutimin dhe marrjen e shpjegimeve në mënyrë direkte në lidhje me kërkesën e shoqatës AAES, ERE zhvilloi një seancë dëgjimore ku ftoi të merrnin pjesë të gjitha palët e interesit.

- Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 21.3.2023 ishin prezent përfaqësues nga shoqata AAES, shoqëria “H&K@ Valamar Residences”, shoqëria “Xhengo Energji” sh.p.k., shoqëria “Albpetrol” sh.a., Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)



sh.a., Avokati i Popullit, dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK).

- Në nenin 144 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, përcaktohet se: “1. Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm, për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky kod. 2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihenin dhe mund të dihenin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.”.

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 32/2023. vendosi hapjen e procedurës “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës shqiptare të furnizuesve të energjisë (AAES)”, nëpërmjet së cilës pranoi kërkesën e AAES por duke e aplikuar për të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë (jo vetëm TM dhe TU) deri në datë 31.12.2023.

- Lidhur me propozimin e AAES-së, për shtyrjen e pikës 1.2 deri në fund të vitit, gjykojmë që duke marrë në konsideratë raportimet e furnizuesve dhe numrin e vogël të tyre që kanë lidhur kontrata furnizimi, shtyrja e pikës 1.2, germës “a” deri më 31.12.2023 nuk ka impakt negativ në vlerësimin e standardeve.

- Për sa i përket propozimit për shtyrjen e pikës 1.2, germës “b” vlerësojmë, se duke qenë se ka metoda të tjera alternative për informimin e klientit, rrjedhimisht klienti nuk cenohet. Një nga këto metoda parashikohet në rregulloren mbi “Kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”. Informimi i klientëve bëhet nëpërmjet faturës.

- Lidhur me propozimin për shtyrjen e pikës 1.2, germës “d” vlerësojmë se shtyrja e dispozitës së propozuar nga AAES-ja deri në fund të vitit nuk përbën problem, pasi numri i konsumatorëve që furnizohen nga furnizuesit në treg të lirë zënë një përqindje shumë të vogël. Aktualisht, në tension të mesëm ka vetëm një konsumator që furnizohet në treg të lirë nga 7600 të tillë.

- Për sa i përket propozimit për shtyrjen e aplikimit të përjashtimit për gjerat “e” dhe “f”, vlerësojmë se marrja e komenteve nëpërmjet

anketave apo formave të tjera është opsionale. Gjithashtu, numri i vogël i konsumatorëve që furnizohen nga furnizues në treg të lirë nuk ndikon negativisht për vlerësimin e këtyre standardeve nga ERE.

- Gjithashtu, në lidhje me propozimin për shtyrje të pikës 1.2, germës “g”, vlerësojmë se duke qenë se është një numër i vogël i konsumatorëve që furnizohen nga furnizues në treg të lirë nuk ndikon negativisht në shërbimet e ofruara nga furnizuesi respektivisht në tension të lartë dhe të mesëm. Gjithashtu, duke qenë se afati i shtyrjes së kësaj dispozite përfshin një periudhë të shkurtër kohore prej 6-mujsh, nuk ndikon në shërbimet e furnizuesve ndaj klientëve.

- Lidhur me propozimin për shtyrje të pikës 1.2, germës “j” vlerësojmë të pranohet pasi klientët njoftohen dhe në mënyra të tjera, p.sh., nëpërmjet faturës së energjisë elektrike dhe si pasojë nuk ka impakt negativ. Nga ana tjetër, ERE synon që brenda 6-mujorit të parë të 2023-shit të realizojë rubrikën informative mbi ofertat e tregut të furnizimit me energji elektrike (PRICE COMPARISON TOOL), e cila ndërgjegjëson konsumatorin për t’u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, për të kuptuar drejt mekanizmat e tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin me energji elektrike.

- Për sa i përket nenit 2, pikës 1, duke marrë shkas që shumë prej të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, të cilët kryejnë këtë aktivitet në treg të lirë janë ende në faza fillestare dhe nuk kanë kryer aktivitet në furnizim, vlerësojmë të saktë të shtyhet kjo dispozitë deri në fund të vitit pasi këto shërbime shihen si kosto dhe kanë impakt negativ te shoqëritë e licencuara.

- Në lidhje me nenin 2, pikën 2, duke pasur parasysh se këto raportime i bëhen me dije ERE-s dhe meqenëse janë të parashikuara dhe në akte të tjera, siç është “Plani i masave për furnizuesin e shërbimit universal për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, nuk përbën problem shtyrja e kësaj dispozite të propozuar nga AAES-ja deri në fund të vitit 2023.

- Për sa i përket informimit të klientëve për çmimin e energjisë elektrike, ERE synon që brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023 të vendosë në funksion Price Comparison Tool dhe në këtë mënyrë parashikohet që klientët që furnizohen në



treg të lirë do të njoftohen mbi çmimet e furnizimit me energji elektrike dhe ofertat e furnizuesve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022.

2. Të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë përjashtohen deri në datë 31.12.2023 nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j” në nenet 2.1 dhe 2.2, si dhe në nenet 4.1. dhe 4.2.

3. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 1 janar 2023.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 24, datë 23.6.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar

Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 23.6.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt, “Mbi miratimin e vendimit Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a.”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a., me shkresën nr. 228 prot. datë 10.3.2023, si dhe me plotësimet me anë të shkresës me nr. 292 prot., datë 30.3.2023 dhe nr. 451 prot., datë 2.6.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Dibër sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruar, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. (NUIS M27109701L) është themeluar më datë 1.9.2022, me aksionarë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, Bashkitë Dibër me 18.80%, Mat me 13.86%, Bulqizë me 12.18%, Klos me 4.16%.

b) Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 125 750 banorë të bashkive Dibër, Mat, Bulqizë, Klos.



c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Halil Jakimi është diplomuar në master shkencor pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, dega Inxhinieri Pyjesh, në vitin 2014.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Dibër sh.a., të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Dibër sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. me (NUIS: M27109701L), në kategoritë:

- a) Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor: Mario Bakalli;
- b) Drejtuese Teknike: Halil Jakimi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. janë bashkitë Dibër, Mat, Bulqizë, Klos.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 301, datë 5.7.2022, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 317, datë 20.8.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mat sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 91, datë 28.7.2020, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 27, datë 23.6.2023

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SEANCËS DËGJIMORE ME PUBLIKUN NË PROCESIN E MIRATIMIT TË TARIFAVE”

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe të “Rregullores për organizimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

KONSTATOI SE:

Rregullorja “Për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave” është miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 71, datë 21.9.2018 dhe është ndryshuar me vendimin nr. 54, datë 14.4.2020. Kjo rregullore shërben për të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen nga operatorët për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun si pjesë e dokumentacionit



të procesit për aplikim për ndryshim të tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Me vendimin e Komisionit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” janë përcaktuar metodologjitë e reja për miratimin e tarifave si dhe me daljen e VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, me qëllim përshtatjen e seancës dëgjimore me këto dy vendime, del e nevojshme kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në këtë rregullore.

Sa më sipër, në mbledhjen e datës 23.6.2023, Komisioni Kombëtar Rregullator:

VENDOSI:

1. Në “Rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave” të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 71, datë 21.9.2018” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në nenin 3, paragrafi i fundit shtohet në fjalinë hyrëse përkufizimi “Shoqëri Rajonale UK”;

b) në nenin 5, pika 2, nënpika 4, shtohen fjalët “në bashkitë përkatëse”;

c) në nenin 6, pika 2, hiqet fjalia “që në zonën e tyre të shërbimit mbulojnë më shumë se një bashki”;

ç) në nenin 7, pika tre pas fjalës së fundit shtohet fjalia “ dhe në rjetet sociale të shoqërisë UK.”;

d) në nenin 9, pika 2, pas fjalisë së parë shtohet fjalia “ gjithashtu përfaqësues të Aksionarëve”;

dh) në nenin 13, fjalia e parë ndryshohet “I gjithë dokumentacioni i organizimit të seancave dëgjimore”;

e) në shtojcën nr. 1, tabelat nga nr. 1 deri në nr. 10 zëvendësohen me tabelat nga nr. 1 deri në nr. 10, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime dhe Enti Rregullator i Ujit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

VENDIM

Nr. 28, datë 23.6.2023

PËR SHTYRJE AFATI TË APLIKIMIT NGA SHOQËRITË UJËSJELLËS- KANALIZIME PËR TARIFA TË UJIT TË PIJSHËM DHE UJËRAVE TË NDOTURA PËR VITIN 2023

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, të “Rregullores për organizimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR),

KONSTATOI SE:

Në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 14, pika “b”, përcaktohet se një ndër kompetencat e KKRR-së është: “ të miratojë çmimet dhe tarifën e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifën për ujërat e përdorura dhe tarifën e trajtimit të tyre...”. Gjithashtu, në nenin 22 të po këtij ligji përcaktohen procedurat për vendosjen e tarifave, ku në zbatim të këtij ligji, KKRR-ja përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave e cila është miratuar me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”.

Me miratimin e VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” është realizuar agregimi i 12 shoqërive ujësjellës-kanalizime nga 15, por që për arsye objektive nuk është përfunduar plotësisht procesi i riorganizimit të brendshëm në shoqëritë e reja rajonale. Neni 10, pika 4 e vendimit nr. 539, datë 30.12.2021, përcakton se: “Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave është data 30 qershor...”. Nga informacioni dhe të dhënat e marra në vazhdimësi nga shoqëritë e reja rajonale si dhe nga kërkesat e paraqitura nga donatorët, konstatohet se ky afat nuk mund të



respektohet në kohën e duhur për arsye të riorganizimit dhe vështirësive të hasura në praktikë nga ana e tyre për plotësimin brenda afatit të aplikimit për nivel të ri tarifor sipas metodologjisë së tarifave, për këto fakte me qëllim dhe përkrahjen e reformës në sektorin ujësjellës-kanalizime del e nevojshme shtyrja e afatit të aplikimit për këto shoqëri përjashtimisht për vitin 2023.

Sa më sipër, në mbledhjen e datës 23.6.2023, Komisioni Kombëtar Rregullator:

VENDOSI

1. Përjashtimisht për vitin 2023, afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave për shoqëritë UK Rajonale është data 31 gusht.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë rajonale ujësjellës-kanalizime dhe të gjitha strukturat e Entit Rregullator të Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 100
Datë: 2023/07/06 15:38:59
34972b8e-962d-4c04-b493-79f0c13ee721

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë